BANKA E SHQIPËRISË

BORXHI DHE KREDIA

=

NJË ÇËSHTJE INTERESI

Ilustrimet: Brikena Berdo

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkoni në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë, Shqipëri,

Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 6000 kopje

Përmbajtja

Hyrje	6
1. Historik – Huadhënia që nga kohët e Mesjetës deri në ditët tona	7
2. Përse disa marrin hua? Përse disa japin hua?	11
3. Çfarë është kredia?	13
4. Kreditë – Borxh i mirë apo borxh i keq?	15
5. Çfarë duhet të konsideroni përpara se të aplikoni për një kredi?	16
6. Një vështrim mbi llojet më të zakonshme të kredive	20
7. Besueshmëria e huamarrësit	24

“Mos jini as huamarrës dhe as huadhënës...”.

(William Shekspir, Hamleti. 1600.)

Kështu shkruajti Shekspiri në një prej veprave të tij. Megjithatë, të gjithëve na ndodh që të hyjmë në borxh ose t’i japim dikujt borxh, të paktën një herë në jetë.

Hyrje

Sot jetojmë në një kulturë e cila i inkurajon pozitivisht njerëzit për të hyrë në borxhe, nëpërmjet kredive dhe kartave të kreditit, në mënyrë që të përballojnë blerjen e prodhimeve të ndryshme në treg. Kur jemi të vegjël mjaftohemi me qindarkat që na japin prindrit. Më vonë marrim një borxh të vogël tek ata, pastaj një 500 lekëshe nga gjyshi apo shoku ynë. Por s'ka problem, sepse po të jemi të përgjegjshëm, këto para do t'i shpenzojmë vetëm në sende të nevojshme. E megjithatë, përsëri në treg kanë dalë një palë atlete të reja, një televizor i ri, sende të cilat na pëlqejnë shumë t'i kemi. Menjëherë pasi mbushim 20 vjeç dhe kemi një punë e cila na siguron të ardhura personale, banka na jep mundësinë të marrim hua së bashku me një mori kartash "për të dekoruar" portofolin tonë. Këto të fundit mund t'i përdorim për të kryer pagesa të ndryshme apo për të tërhequr para nga llogaria jonë bankare, në qoftë se kemi një të tillë. Më pas vjen koha për t'i shlyer të gjitha, bashkë me interesin, sepse gjithçka konsiderohet një borxh.

1. Historik - Huadhënia që nga kohët e Mesjetës deri në ditët tona

Origjina e huadhënies mendohet se daton që në kohët biblike, proces i cili përmendet edhe në shkrimet e shenjta. Megjithatë, të dhënat mbi huanë dhe shfaqja e formave moderne të saj shënohen në periudhat e Mesjetës dhe të Rilindjes.

- Huadhënia në fillimet e Mesjetës.

Duke rrëmuar në origjinën e huamarrjes gjatë periudhës së Mesjetës, vihet re se, në të shumtën e rasteve, huatë u sillnin fitim vetëm huadhënësve.

Pronarët e tokave dhe të pasurit u jepnin hua shtresave më të varfra të shoqërisë së asaj kohe, duke u vënë norma të larta interesi ose duke i detyruar huamarrësit të punonin në mënyrë që të paguanin borxhin. Huadhënësi mund edhe të vështirësonte me dashje kushtet e huasë kur huamarrësi pothuajse e kishte paguar borxhin, në mënyrë që borxhliu të vazhdonte të kryente pagesa ose të punonte për huadhënësin.

Në qoftë se huamarrësi nuk do të ishte në gjendje të shlyente borxhin, ai dënohej pa gjyq, futej në burgun e borxhlinjve, derisa dikush tjetër të mund të paguante borxhin e tij ose të kryheshin marrëveshje të tjera për lirimin.

• Huadhënia në periudhën e Rilindjes.

Nga fundi i Mesjetës dhe gjatë periudhës së Rilindjes, huaja filloi të merrte kthesë dhe formë drejt asaj që ne njohim sot. Individët e njohur si fajdexhinj e ushtronin profesionin e tyre në sheshe tregtimi, duke vendosur stola që quheshin "banca" (origjinë e fjalës bankë në përdorimin e sotëm modern të saj), në të cilat kryenin veprimet e tyre.

Në të njëjtën zonë mund të punonin shumë fajdexhinj, duke rritur konkurrencën, e cila ulte dhe normat e larta të fitimit që merreshin në atë kohë. Megjithatë, edhe me rritjen e konkurrencës tregtia e fajdexhinjve nuk ishte krejtësisht e ndershme.

Fajdexhinjtë përpiqeshin të nxirrnin sa më tepër fitim prej huamarrësve, dhe shkonin deri aty sa falsifikonin të dhënat e pagimit të borxhit dhe veprimet e tjera, në mënyrë që të përfitonin sa më tepër para nga ajo shtresë që ishte më e pafat dhe më pak e shkolluar. Në atë kohë, burgjet e borxhlinjve ishin shumë të përhapura dhe në disa zona ishin të mbushura plot me njerëz, të cilët kishin shumë pak shpresa për t'u liruar.

- Huadhënia në kohët moderne.

Me kalimin e kohës u zhvilluan edhe format moderne të huasë. Tashmë është e lehtë të vihet re se sa shumë kanë përparuar praktikat e huasë që nga periudha e origjinës së tyre.

Me kalimin e dekadave dhe të shekujve, njerëzimi hoqi dorë nga format e padrejta të huadhënies dhe nga burgjet e borxhlinjve.

Tashmë ka institucione të mirërregulluara që kontrollojnë normat e interesit në banka apo dhe në institucione të tjera financiare kredidhënëse. Institucionet financiare ose huadhënësit modernë, përpiqen të ofrojnë një shërbim të vlefshëm si për individët ashtu edhe për biznesin, duke ofruar norma interesi të arsyeshme dhe kushte të mirëpërcaktuara.

2. Përse disa marrin hua? Përse disa japin hua?

Në jetën e përditshme na ndodh më shumë se një herë të kuptojmë që gjendja jonë financiare nuk na lejon mundësinë e të blerit të të mirave materiale, që shpesh mund të jenë elemente jetësore. Ndërkohë që dikush tjetër, jo vetëm plotëson me tepri kërkesat e veta, por vazhdimisht i mbeten para të tepërta. E njëjta gjë ndodh edhe për bizneset.

Ekzistenca e këtyre dy palëve, natyrshëm të çon në përfundimin se pamundësinë e përkohshme që ke për të financuar blerjen apo investimin e nevojshëm, mund ta realizosh duke kërkuar hua.

Në kohët moderne, bashkimin e atij që ka nevojë për para me atë që ka tepri parash, e bëjnë institucione të specializuara, të cilat ne i quajmë: banka.

Të shohim edhe disa prej shkaqeve të tjera se përse disa japin hua dhe disa marrin hua:

- **ofruesit e huave.** Ata që furnizojnë me para tregjet financiare apo këdo që është i interesuar e bëjnë diçka të tillë për dy arsye: (1) dëshirojnë të ruajnë para, të cilat mund t'i shpenzojnë për diçka tjetër më vonë si për shembull, për edukim ose për ndërtimin e një fabrike; (2) joshen nga marrja e një fitimi, siç mund të jetë interesi.

- **kërkuesit e huave.** Ata që hyjnë në borxh e bëjnë një gjë të tillë për të realizuar planet e tyre. Njerëzit shpesh duan të blenë shtëpi ose mallra të tillë si pajisje shtëpie apo makina, por nuk kanë para të mjaftueshme. Edhe bizneset kërkojnë hua për të investuar në makineri apo mjete të reja, sepse presin të marrin një fitim prej tyre.

3. Çfarë është kredia?

Kredia është një sasi parash të marra hua që duhen kthyer në një periudhë kohe të caktuar së bashku me një interes. Shuma e parave që merret hua në gjuhën e bankës quhet principal dhe interesi është kostoja e kësaj huaje. Kohëzgjatja që vendoset për të paguar kredinë njihet si afati i kredisë.

Në kohët e sotme, financierët ofrojnë këshilla të shumta se në çfarë rastesh mund të vendosësh të marrësh një kredi. Si shkak për të marrë një kredi mund të shërbejë blerja e diçkaje që kushton më shumë nga sa mund ta përballoni, si për shembull blerja e një makine, e një shtëpie (apo për të rregulluar atë që keni), dëshira për të shkuar me pushime apo për të vazhduar studimet. Mbani mend se, kur aplikoni për një shumë të caktuar kredie duhet të siguroheni që jeni në gjendje ta paguani atë çdo muaj, përndryshe kjo mund t'ju shkaktojë probleme të mëdha financiare.

Problemi i vetëm me huatë është që ato duhet të paguhen përsëri!!!

4. Kreditë – Borxh i mirë apo borxh i keq?

Një pyetje e rëndësishme që duhet t'i drejtoni vetes kur hyni në borxh është nëse shuma e marrë po krijon një borxh të mirë apo të keq.

Borxh i mirë konsiderohet kur huaja merret për diçka të cilës do t'i rritet vlera me kalimin e kohës. Për shembull, blerja e një prone të patundshme, hapja e një biznesi ose marrja e huasë për qëllime edukimi, konsiderohen si arsye të mira për të hyrë në borxh.

Veçanërisht, huatë për qëllime edukimi konsiderohen si borxh i mirë sepse në të ardhmen një edukim më i mirë do të rrisë të ardhurat tuaja. Ndërsa, borxh i keq konsiderohet atëherë kur ju merrni një veprim të pamatur financiar dhe nuk jeni në gjendje ta shlyeni huanë brenda afatit të caktuar.

5. Çfarë duhet të konsideroni përpara se të aplikoni për një kredi?

Këtu jepen disa këshilla të vlefshme që duhen marrë në konsideratë përpara se të aplikoni për një kredi.

Në rast se ju duhen para për të rikonstruktuar shtëpinë, dhe mendoni se përgjigja është kredia për shtëpi, konsiderojini edhe një herë të gjitha mundësitë tuaja. Në qoftë se nuk jeni në gjendje të kryeni pagesat e kërkuara, atëherë ju mund të humbisni shtëpinë tuaj, të cilën e keni përdorur si garanci për të siguruar kredinë që keni marrë. Prandaj është e rëndësishme të mos lejoni askënd të përpiqet t'ju mbushë mendjen që të përdorni shtëpinë tuaj si garanci për të marrë një hua, të cilën nuk do të jeni më në gjendje ta paguani.

Për të patur zgjidhjen më të mirë duhet të njiheni me çfarë ofron tregu, cilat janë institucionet që ofrojnë kredi dhe cilat janë kushtet specifike të tyre.

Mënyra më e mirë do të ishte kontaktimi me disa huadhënës – duke përfshirë bankat, shoqëritë e kursim-kreditit apo dhe fondacione të mikrokredisë. Pyesni


Afati i kredisë
2
Pagesa mujore
3
Norma vjetore në përqindje
1
Kushtet e parapagimit
4

çdo huadhënës rreth huasë më të mirë për të cilën mund të aplikoni dhe pastaj krahasoni elementet e mëposhtme:

Norma vjetore në përqindje.

Norma vjetore e huasë është elementi më i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë kur jeni duke aplikuar për një kredi. Ajo përfshin jo vetëm normën e interesit, por edhe disa lloje të tjera pagesash që kërkohen nga huadhënësi, të shprehura në terma vjetorë.

Norma e interesit ndryshon në përputhje me zhvillimet ekonomike. Për këtë arsye, në periudhën kohore të shlyerjes së kredisë mund të ndodhë të ulet ose të rritet.

Afati i kredisë.

Afati i kredisë është periudha kohore gjatë të cilës huamarrësi duhet të kryejë pagesat kundrejt bankës, në mënyrë që të shlyejë kredinë e marrë së bashku me interesin e saj. Për sa vite do t'i kryeni pagesat për kredinë tuaj? Në qoftë se jeni duke marrë një kredi për shtëpi, mos harroni që kjo kredi mund të kërkojë pagesa për një kohë relativisht të gjatë.

Pagesa mujore.

Pagesat mujore përfshijnë interesin e kredisë së përfituar dhe një pagesë të vogël të bazës së kësaj shume pa interesin.

Kushtet e parapagimit.

Ndodh që juve ju lind mundësia të shlyeni kredinë para afatit të vendosur në kontratën e kredisë. Ky fakt merret parasysh që në fillim kur lidhet kontrata, duke përcaktuar kështu edhe disa kushte parapagimi. Këto mund të jenë në formën e pagesave ekstra nëse ju shlyeni kredinë tuaj para kohe.

Në përfundim, këshilla më e mirë do të ishte që të siguroheni që ju mund të përballoni kredinë. Sigurohuni mirë nëse të ardhurat tuaja mujore janë të mjaftueshme për të mbuluar pagesat mujore të kredisë, përveç faturave dhe shpenzimeve që mund të keni. Nëse kjo nuk është e mundur, hiqni dorë nga kredia.

6. Një vështrim mbi llojet më të zakonshme të kredive

Pjesa në vazhdim ju njeh me disa lloje të kredive që ju mund të hasni më shpesh.

Kredi për studime.

Kredia për studime është ajo lloj kredie e cila ju mundëson të keni një shumë parash për të vazhduar studimet. Shumë kredi për studentë kanë një mundësi pagimi të ngadalësuar, duke i lejuar ata të shlyejnë kredinë pasi të kenë mbaruar studimet.

Kredi për makinë.

Kredia për makinë është një kredi, e cila përdoret për blerjen e një automjeti. Ky automjet që blihet mund të përdoret si garanci për kredinë, duke i dhënë mundësi një personi ta blejë mjetin pa patur nevojë të vendosë një kolateral tjetër për ta siguruar atë.

KREDI

Kredi për shtëpi.

Kredia për shtëpi është një kredi, e cila përdoret për të blerë apo për të rregulluar një shtëpi ose një pronë të patundshme. Ajo është një prej llojeve më të zakonshme të kredive.

Kjo lloj kredie ka tendencën të ketë interesa dhe mundësi pagimi të ndryshme. Ajo mund të sigurohet nga një sërë huadhënësish, duke përfshirë edhe bankat dhe kompanitë financiare.

KARTAT E KREDITIT

Zakonisht kartat e kreditit lëshohen nga institucionet financiare, të cilat besojnë se klientët do të jenë në gjendje t'i shlyejnë detyrimet e tyre brenda afatit. Karta e kreditit në përgjithësi ka një kufi, i cili përfaqëson shumën e kredisë që institucioni i ofron përdoruesit të kësaj karte. Shuma e vënë në dispozicion për përdorim nuk është gjë tjetër, veçse kursimet e vendosura nga klientët e tjerë në institucionin që iu ka lëshuar kartën. Klientëve u paguhet një interes për kursimet e tyre të depozituara pranë këtyre institucioneve. Rrjedhimisht, institucionet financiare duhet të sigurohen që çdo muaj, mbajtësit e kartave të kreditit, kryejnë pagesa të mjaftueshme, në mënyrë që të mbulohet interesi i paguar kundrejt klientëve, të mbulohen kostot e transaksioneve etj., dhe gjithashtu të nxirret edhe një fitim.

7. Besueshmëria e huamarrësit.

Në qoftë se dëshironi të aplikoni për një kredi, ju duhet të provoni që jeni në gjendje ta shlyeni atë. Kjo zakonisht njihet si “besueshmëria e huamarrësit” dhe është një vlerësim i aftësive tuaja për të marrë dhe për të paguar përsëri borxhin tuaj. “Besueshmëria e huamarrësit” përcaktohet nga tre kritere të cilat njihen si tre “K”-të e saj.

Kapitali.

Në çdo rast banka, para se të vendosë për t’iu dhënë kredi, do të interesohej të dinte se ç’do të ndodhë nëse ju nuk jeni në gjendje të shlyeni kredinë tuaj. Kreditori do të dijë se çfarë alternativash rezervë keni ju. Më konkretisht, çfarë mjetesh apo kapitali keni ju, të cilat mund t’i shisni në mënyrë që të përfitoni burime financiare të mjaftueshme për të paguar huanë. Mjeti që ju përdorni “për të siguruar” një hua njihet si “kolateral”.

Karakteri.

Një kreditor kërkon të ketë disa të dhëna që huamarrësi është i përgjegjshëm dhe i kryen pagesat në rregull. Kur ju aplikoni për një hua, specialisti i huasë do të takohet me ju dhe do të përpiqet të përcaktojë karakterin tuaj dhe sa i përgjegjshëm dhe i besueshëm jeni. Disa prej pyetjeve që ju duhet t'u përgjigjeni kur aplikoni për një hua, mund t'ju duken të çuditshme. Juve mund t'ju pyesin se për sa kohë keni punuar në punën aktuale; sa kohë keni jetuar në adresën aktuale; dhe nëse keni marrë borxh më parë. Një pyetje tjetër është nëse jeni i martuar? Të punosh në një punë për një kohë të gjatë, të jetosh diku për një kohë të gjatë, të jesh i martuar ose të kesh fëmijë tregojnë stabilitet dhe përgjegjësi. Kjo nuk do të thotë që ju nuk mund të merrni dot një hua në qoftë se nuk jeni i martuar me dy fëmijë dhe nuk keni punuar në të njëjtin vend për 10 vjet. Por, do të thotë që në qoftë se keni ndryshuar vendin e punës shpesh herë, keni lëvizur nga një vendbanim në tjetrin shpesh, ju mund të dalloni njëfarë hezitimi nga specialisti i kredisë kur aplikoni për një hua.

Kapaciteti.

Kreditori do të jetë gjithashtu i interesuar në kapacitetin tuaj për të marrë borxh. A keni të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kështet mujore? A keni marrë një shumë huaje e cila rrezikon aftësinë tuaj për të paguar? Sa të holla keni? Sa borxhe keni? Mjetet dhe niveli i të ardhurave tuaja do të krahasohen me kostot e huasë në mënyrë që kreditori të mund përcaktojë nëse duhet apo jo t'ju miratojë kredinë.

Shembull.

Drini është një student në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë. Në çdo fund viti arsimor, fakulteti zgjedh studentët më të mirë dhe Drini është një prej tyre. Ai është krenar që përpjekjet e tij nuk kanë shkuar dëm. Por, ai kërkon që të zgjerojë dijet e tij duke vazhduar studimet pasuniversitare. Për këtë nevojiten shpenzime financiare, të cilat Drini dhe familja e tij nuk janë në gjendje t'i përballojnë.

Megjithatë Drini nuk i humbet shpresat. Ai fillon të kërkojë mënyra se si mund të përballojë shpenzimet për të vazhduar studimet pasuniversitare dhe më në fund gjen një të tillë, shumë të mirë. Ai vendos të kërkojë ndihmë në një prej bankave tregtare, të cilat ofrojnë kredi për edukim dhe më në fund e gjen bankën e tij.

Banka të cilës Drini i drejtohet, ofron një kredi me afat maksimal deri në 2 vjet dhe shuma që ajo ofron është deri në 20.000 usd ose ekuvalenti në lekë apo në euro. Nga ana tjetër, atij i kërkohet të sigurojë kredinë, duke vendosur si kolateral të saj hipotekën e një pasurie të patundshme. Për këtë ai i kërkon ndihmë prindërve të tij, të cilët menjëherë pranojnë ta ndihmojnë dhe vendosin t'i japin hipotekën e apartamentit të tyre. Pasi ka dorëzuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm: formularin e plotësuar, të dhëna të qarta për të ardhurat e tij dhe gjendjen financiare, banka i jep huanë. Tani Drinit nuk i mbetet tjetër veçse të fillojë përgatitjet për studimet pasuniversitare.